



Mediterranea 19

Bienalja e Artistëve të Rinj

Shkolla e Ujërave

Publikimi i listës së artistëve shqiptar fitues që do të jenë pjesë e “MEDITERRANEA 19 – SCHOOL OF WATERS”, Bienalja e Artistëve të Rinj

Bienalja e Artistëve të Rinj Mediterranea 19 - *Shkolla e Ujërave* informojmë se përkundër situatës BJCEM, ka vazhduar të punojë në mënyrë të qëndrueshme. Në marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe Kulturës të Republikës së San Marinos, Institutet Kulturore të Republikës së San Marinos dhe Universitetin e San Marinos, kuratorët kanë vendosur për të vazhduar ecurinë e aktivitetit duke publikuar zyrtarisht listën e artistëve të zgjedhur për të marrë pjesë në Bienalen “MEDITERRANEA 19 – School of Waters”.

<http://www.bjcem.org/mediterranea19/>

Bordi kuatorial i BJCEM, ka përzgjedhur tre artistë shqiptare të cilët janë vlerësuar nga grupi kuratoreve i Bienales për nga cilësia artistike dhe koncept-ideja e tyre. Ministria e Kulturës si anëtare e shoqatës BJCEM do të përfaqësohet në këtë Bienale me 2 (dy) artistë dhe 1 (një) artist Bashkia Tiranë.

Artistët e përzgjedhur janë:

1. Bora Baboci
2. Alcaeus Spyrou
3. Endi Tupja

Me qëllim që BJCEM, mos të humbasë ecurinë e zhvillimit të saj ka vendosur që Bienalia të realizohet në një realitet dixhital për të siguruar një alternative pozitive për vështirësitë aktuale dhe kufizimet e lëvizshmërisë me të cilat po përballemi të gjithë.

Ekipi kuratorial i Shkollës së Ujërave, i udhëhequr nga agjencia simbolike e ujërave konceptoi një platformë editoriale <https://mediterraneabiennial.org/> e cila funksionon si një platformë e hapur cdo ditë duke ruajtur komunikimet me artistët në mënyrë që mund të shkarkojnë informacione të ndryshme, kontributet e kuratorëve dhe artistëve që kanë qenë përzgjedhur në bienale, një bazë edukative ku idetë nxiten, proceset mblidhen dhe shumohen duke gjeneruar sinkretizma që ndërtojnë gradualisht ekosistemin e Mediterranea 19.

Shoqata BJCEM, informon se, situata e krijuar nga pandemia COVID-19 e ka bërë të domosdoshme shtyrjen zyrtare të Bionalës *Mediterraanea 19* deri në vitin 2021, datat specifike do të shpallen në kohën e duhur.